

JETOJMË ME PARIMET



E DEMOKRACISË

E ARDHMJA E VENDIT VARET NGA NE

ANILA (14), GRANIT (13), YLL (14), ADEA (13), VERONA (13), YLLËZA (14), RINGA (13)



Lexues të dashur, ju ftojmë ta lexoni artikullin tonë për të parë se sa i rëndësishëm është roli ynë në të ardhmen e këtij vendi

Si në çdo vend tjetër demokratik, edhe ne i kemi të drejtat e barabarta. Duhet ta kuptojmë se sa i rëndësishëm është roli ynë në demokraci dhe se ne jemi ata të cilët e kemi rolin më vendimtar në vendin tonë. E ardhmja e këtij vendi është në duart tona. Është mirë që të marrim pjesë në çdo vendim, i cili ka të bëjë me ne dhe me të ardhmen tonë.

Tani do t'iu tregojmë se si ndahet demokracia dhe cilat janë elementet e saj më të rëndësishme. Elementet më të rëndësishme të demokracisë janë: toleranca, paqja, barazia, bashkëpunimi, solidariteti, respekti etj.

Demokracia për herë të parë është shfaqur në Greqi në vitin 507 para erës sonë. Atëherë nuk ka pasur demokraci të plotë, ngaqë të drejtën e votës e kanë pasur vetëm burrat e pasur. Në të kaluarën, gratë nuk

e kishin të drejtën e votës, e po ashtu as të varfërit. Ata ishin gjithnjë të shkelur dhe fjalët e tyre nuk dëgjoheshin. Kurse demokracia e sotme, dallon shumë nga e kaluara. Sot demokracia është më e përfunduar dhe ne po mundohemi që çdo ditë e më shumë t'iu përmbahemi elementeve kryesore të saj. Demokracia ndahet në demokracinë e drejtpërdrejtë dhe përfaqësuese. Ajo e drejtpërdrejtë paraqitet më së shumti në shtetet e vogla, ku vendimet merren në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe shumë shpejt. Kurse, ajo përfaqësuese përdoret edhe tek ne, ku deputetët zgjedhen nga votat e qytetarëve. Pra, deputetët zgjedhen nga ana jonë. E pastaj ata deputetë zgjedhin Presidentin e shtetit tonë. Me anë të votave tona, ne i zgjedhim përfaqësuesit tanë dhe presim nga ata që të na përfaqësojnë neve në mënyrën më të mirë të mundshme. Pra, lexues të dashur, ne të gjithë duhet që të mendojmë për një të ardhme të suksesshme dhe me shumë dashuri, paqe dhe lumturi me njëri-tjetrin.




Demokracia është shprehje e lirë



Autorët e artikullit

JETA PAQËSORE E NJË QYTETARI

BLERON (14), GERTA (14), BLUDINA (14), SELVER (15), ELVIRA (13), UMEJSA (14), ANESA (14)



Mbrojtja dhe pastrimi i ambientit - përgjegjësi e jona



Autorët e artikullit

Ne sot jemi gazetarë dhe tema e artikullit tonë flet se si mund të jemi qytetarë aktiv


Qytetarë janë të gjithë ata njerëz të cilët i përkasin një territori të caktuar. Pra, janë pjesë e një shteti.

Ne si qytetarë kemi mjaft detyra, si dhe kemi shumë përgjegjësi. Kurse, çdo njeri që i përket kësaj bote ka të drejta. Marrim shembull, një fëmijë nga dita që lind ka të drejtën e emrit, të drejtën e kujdesit prindëror, të drejtën për strehim etj. Me kalimin e kohës gjersa rritet, shtohen edhe më shumë të drejta, siç janë: e drejta e lojës, e drejta e arsimit, e drejta e lëvizjes, e shumë të drejta të tjera. Dallimi mes detyrave dhe përgjegjësi është i vogël, por prapë se prapë ekziston një dallim mes tyre. Detyrat janë obligime ligjore për të gjithë qytetarët e Kosovës, ndërsa përgjegjësitë është mirë që t'i kryejmë gjatë tërë kohës. Përgjegjësitë tona në demokraci janë të ndryshme. E ne si përgjegjësi kemi: respektimin e ligjit, mbrojtjen e ambientit, respektimin e të tjerëve, etj. Po ashtu, ne padyshim se kemi edhe të drejtat tona duke filluar nga: e drejta e lojës, e drejta e shprehjes së lirë, e drejta e votës, e drejta e barazisë pa dallim gjinie, race, etnie, feje, pozite sociale etj.

Për të qenë qytetarë shembullor duhet edhe të jemi aktiv për qëllime të ndryshme, duke marrë pjesë në organizata të ndryshme joqeveritare, klube, shoqata etj. Ne do të jemi qytetarë aktiv dhe do të mendojmë vetëm për të mirën e këtij vendi.

KUVENDI, INSTITUCIONI YNË MË I LARTË

ERMIRA (13), RIGA (13), LAIDA (13), ARGJENT (13), NUE TIMON (13), GENTIJANA (13), RINESA (13)



Deputetët tanë janë të obliguar të na përfaqësojnë në Kuvend dhe të marrin vendime për të mirën e popullit tonë

Kosova është vendi ynë demokratik, i shpallur shtet më 17 shkurt të vitit 2008. Kushtetuta e vendit tonë të pavarur është fuqizuar plotësisht, pikërisht në këtë vit më 15 prill. Forma e qeverisjes në vendin tonë është demokracia. Fjala demokraci nga gjuha greke do të thotë: „demos“ - popull dhe „kratia“ - qeverisje (qeverisje e popullit). Demokracia është e ndarë në demokraci përfaqësuese dhe të drejtpërdrejtë. Në vendin tonë, mbizotëron demokracia përfaqësuese, apo më saktësisht ajo parlamentare. Kuvendi - Parlamenti konsiderohet pushteti i parë i vendit.

Kuvendi si institucioni ynë më i lartë legjislativ ngërthen në vete përgjegjësitë dhe detyrat e veta në përfaqësimin e shtetit. Në këtë institucion janë gjithmonë të angazhuar një numër i madh i deputetëve, të cilët janë gjithsej 120. 20 prej tyre përfaqësojnë komunitetet jo shumicë, të cilat jetojnë në Republikën e Kosovës, kurse 100 të tjerë përfaqësojnë qytetarët shumicë dhe kërkesat e tyre. Në Kuvend, seancat janë të udhëhequra nga Kryetari i Kuvendit. Përkatësisht, në këtë anë të sallës gjenden edhe zyrtarë të tjerë të lartë si: Kryeministri dhe ministrat. Deputetët, të cilët na përfaqësojnë neve si qytetarë votojnë për Presidentin dhe Kryeministrin. Kjo është edhe arsyeja pse Kosova qeveriset sipas parimeve të demokracisë përfaqësuese parlamentare.


Në Kuvendin e Republikës së Kosovës gjenden hapë-

sirat e caktuara në mënyrë që çdo qytetar të ketë mundësi të ndjek seancat plenare nga afër dhe të informohet për atë se çfarë ligjesh po miratohen. Miratimi i ligjeve, zbatimi si dhe kontrolli i zbatimit të tyre janë punët kryesore që bën Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Ligjet miratohen sipas votave të deputetëve të cilët na përfaqësojnë neve si qytetarë. Të gjitha ligjet që miratohen dhe që kanë qenë të miratuara duhet të përputhen me ligjet e Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe janë të ndara në nene. Ligjet të cilat janë të shkruara në Kushtetutë mbrojnë të gjitha liritë dhe të drejtat e secilit individ. Mënyra e fillë e qeverisjes në vendin tonë ka bërë që Republika e Kosovës të njihet si shtet demokratik me plot kuptimin e fjalës. Ne na udhëheqin personat që i kemi votuar vet, duke u bazuar në preferencat dhe kërkesat tona. E më e rëndësishmja, duke u bazuar në aftësitë e kandidatëve për të na përfaqësuar në mënyrën më të mirë të mundshme, duke krijuar edhe më shumë barazi në shoqëri, jetë më të mirë dhe suksese të shumta për vendin tonë demokratik.




Ne e çojmë përpara një vend demokratik



Ne jemi të vetëdijshëm për të drejtat dhe përgjegjësitë tona, sepse ne jemi qytetarë aktiv




Demokracia, sistemi më i mirë i qeverisjes. Ne jemi të lumtur që jetojmë në demokraci




Demokracia ndahet në dy degë kryesore. Ne i kemi paraqitur ato përmes këtij vzatimi



Të jesh qytetar aktiv do të thotë të punosh për të mirën e vendit tënd



E ardhmja është në duart tona



Tri institucionet kryesore në demokraci



IMPRESUM



Ky publikim është produkt i punës së pjesëmarrësve të projektit „Demos-ti“ i cili realizohet nga



REPUBLIKA E KOSOVËS / KUVENDI
REPUBLIKA KOSOVA / SKUPŠTINA
REPUBLIC OF KOSOVO / ASSEMBLY

i implementuar nga



Projekti është mundësuar dhe përkrahur nga



ERSTE Stiftung

Redaktohet nga
Kuvendi i Kosovës

Qëllimi i publikimit
Edukimi qytetar nëpërmes metodave edukative joformale

shtypur nga
TOKA

Na kontaktoni për të marrë pjesë: Pjesëmarrësit:
Tel: +381 38 704 560 SHFMU „Nazim Gafurri“
E-mail: info@demos-ti.org Klasa: VIII-3
Website: www.demos-ti.org Vendi: Prishtinë